



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-07

Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith, III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 9 nëntor 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Urdhër mbi Caktimin e Datës për Planin e Punës dhe Afatet për Hapat e
Mëtejshëm Proceduralë**

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Valeria Boliçi

Mathju Halling

Xhejms Paç

Mbrojtjes së Hysni Gucatit

Xhonatan Elistan Ris

Hju Bauden

Elinor Stivenson

Mbrojtjes së Nasim Haradinajt

Tobi Kadman

Karl Bakli

Xhonathan Piter Uorbois

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), në bazë të nenit 40(2) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 72(2), 116, 119, 129 dhe 130 të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), nxjerr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 5 nëntor 2021, Trupi Gjykues dëgjoi dëshminë e dëshmitarit të fundit të Zyrës së Prokurorit të Specializuar ("ZPS"), W04876. Më të njëjtën ditë, Trupi Gjykues vendosi mbi pranueshmërinë e provave materiale paraqitur përmes dëshmitarit W04841 dhe bëri të ditur se më pas do të paraqiteshin arsyet me shkrim.¹
2. Më të njëjtën ditë, Trupi Gjykues urdhëroi Mbrojtjen që të kërkojë marrjen në pyetje të mëtejshme të dëshmitarëve W04841 dhe W04842 brenda pesë deri në tetë ditësh pas çdo vendimi përfundimtar lidhur me aspekte të rregullës 102(3).²
3. Më 8 nëntor 2021, Trupi Gjykues dëgjoi prej Mbrojtjes propozimet mbi afatet për paraqitjen e mocioneve për rrëzimin e akuzave dhe nëse Mbrojtja do të paraqiste prova në qoftë se Trupi Gjykues do të konstatonte se ekzistonte arsyeja për këtë.³
4. Më 9 nëntor 2021, Trupi Gjykues nxori një vendim përmbledhës ku paraqiti me shkrim arsyet të urdhrit gojor për pranimin e provave materiale të paraqitura përmes dëshmitarit W04841 dhe vendosi mbi klasifikimin e një numri provash materiale.⁴

¹ Urdhri gojor, Versioni jopërfundimtar i transkriptit të seancës më 5 nëntor 2021, f. 1912 rreshti 21 deri në f. 1914 rreshti 17.

² Urdhri gojor, Versioni jopërfundimtar i transkriptit të seancës më 5 nëntor 2021, f. 1970 rreshti 21 deri në f. 1971 rreshti 10.

³ Versioni jopërfundimtar i transkriptit të seancës më 8 nëntor 2021, f. 2029.

⁴ F00427, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Pranueshmërinë e Provave Materiale të Shtyra dhe Klasifikimin e Disa Provave Materiale të Pranuarë*, 9 nëntor 2021.

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

5. Në bazë të nenit 40(2) të Ligjit, Trupi Gjykses garanton proces gjyqsor të drejtë dhe të shpejtë në pajtim me Rregulloren dhe respektim të plotë për të drejtat e të akuzuarve. Pasi të ketë dëgjuar palët, Trupi Gjykses mund të miratojë procedura dhe mënyra që janë të nevojshme për të mundësuar zhvillimin e drejtë dhe të shpejtë të procesit.

6. Në pajtim me rregullën 72(2) të Rregullores, çdo trup gjykses i caktuar në një çështje sipas nenit 15(2) të Ligjit mund të shkurtojë afatet dhe të marrë çdo masë tjetër që e gjykon të nevojshme për përshpejtimin e procedimit, duke i kushtuar vëmendjen dhe kujdesin e duhur të drejtës së të akuzuarit për gjykim të drejtë.

7. Në pajtim me rregullën 119 të Rregullores, nëse Mbrojtja vendos të paraqesë prova – pas një vendimi në pajtim me rregullën 130 të Rregullores, Trupi Gjykses urdhëron Mbrojtjen të dorëzojë listën e dëshmitarëve që synon të thërrasë dhe listën e provave materiale të propozuara që synon të paraqesë, nëse ka. Trupi Gjykses mban konferencën përgatitore për Mbrojtjen brenda shtatë (7) ditësh nga data e dorëzimit të këtyre dy listave.

8. Në pajtim me rregullën 129 të Rregullores, kur nuk ka më dëshmitarë për t'u thirrur ose materiale të tjera provuese për t'u paraqitur Prokurori i Specializuar e mbyll paraqitjen e provave të veta.

9. Në pajtim me rregullën 130 të Rregullores, Mbrojtja i paraqet mocionet për rrëzimin e një ose të gjitha akuzave në aktakuzë brenda dhjetë (10) ditësh nga mbyllja e paraqitjes së provave prej Prokurorit të Specializuar dhe ZPS-ja mund të përgjigjet brenda dhjetë (10) ditësh pas dorëzimit të mocionit.

III. DISKUTIM

10. Në fillim, Trupi Gjykses vëren se Prokurori i Specializuar nuk ka më dëshmitarë për të thirrur apo materiale të tjera provuese për të paraqitur në kuadër të paraqitjes së provave prej Prokurorit të Specializuar, siç është konfirmuar nga ZPS-ja.⁵ Trupi Gjykses më tej vëren se, siç është njoftuar,⁶ vendimi i vet përmbledhës i 9 nëntorit 2021 vendosi mbi aspektet e fundit të pazgjidhura në lidhje me provat e ZPS-së.⁷ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses udhëzon Prokurorin e Specializuar që zyrtarisht ta mbyllë paraqitjen e provave të veta në pajtim me rregullën 129 të Rregullores, nëpërmjet njoftimit me shkrim.

11. Trupi Gjykses thekson se të dy ekipet e Mbrojtjes konfirmuan synimet e tyre se do të paraqesin një mocion për rrëzimin e ndonjë ose të gjitha akuzave në pajtim me rregullën 130 të Rregullores dhe gatishmërinë e tyre për ta bërë këtë deri më 17 nëntor 2021.⁸ Trupi Gjykses vëren më tej se Mbrojtja ka bërë të ditur se, nëse do ti duhet të paraqesë prova, Mbrojtja synon të paraqesë prova, që mund të fillojë në fillim të dhjetorit 2021.⁹

12. Trupi Gjykses vlerëson se afatet e propozuara nga Mbrojtja janë të zbatueshme në rrethanat aktuale, me përjashtim të ndonjë zhvillimi të paparashikuar. Trupi Gjykses vëren më tej se, në pajtim me rregullën 72(2) të Rregullores, procesi aktual mund të vijojë me afate të shkurtuara, duke i kushtuar vëmendjen dhe kujdesin e duhur të drejtës së të akuzuarve për gjykim të drejtë.

13. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses e vlerëson të përshtatshme të urdhërojë Mbrojtjen të dorëzojë çdo mocion sipas rregullës 130 të Rregullores deri më 17 nëntor 2021, ora 16:00. Çdo përgjigje nga ZPS-ja duhet të dorëzohet deri më 24

⁵ Versioni jopërfundimtar i transkriptit të seancës më 8 nëntor 2021, f. 2041. *Shih gjithashtu* Versioni jopërfundimtar i transkriptit të seancës më 5 nëntor 2021, f. 1966.

⁶ Versioni jopërfundimtar i transkriptit të seancës më 8 nëntor 2021, f. 2030.

⁷ Versioni jopërfundimtar i transkriptit të seancës më 8 nëntor 2021, f. 2030.

⁸ Versioni jopërfundimtar i transkriptit të seancës më 8 nëntor 2021, f. 2030 (Gucati), 2036 (Haradinaj).

⁹ Versioni jopërfundimtar i transkriptit të seancës më 8 nëntor 2021, f. 2034-2035, 2037.

nëntor 2021, ora 16:00. Trupi Gjykses synon të nxjerrë një vendim sipas rregullës 130 të Rregullores deri më 26 nëntor 2021, ora 16:00.

14. Gjithashtu, në rast se Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtjes i duhet të paraqesë prova, Mbrojtja urdhërohet të dorëzojë parashtrimet e veta sipas rregullës 119(2) të Rregullores, deri më 29 nëntor 2021. Si hap të mëtejshëm, Trupi Gjykses e konsideron të përshtatshëm caktimin e konferencës përgatitore për Mbrojtjen më 2-3 dhjetor 2021. Trupi Gjykses vëren se në konferencën përgatitore për Mbrojtjen do të trajtohen edhe kërkesat në pritje të vendimit në lidhje me dëshmitarët e propozuar të Mbrojtjes¹⁰ e vendimi me gojë ose me shkrim do të nxirret deri më 3 dhjetor 2021. Trupi Gjykses paraprakisht cakton datën e hapjes së paraqitjes së provave prej Mbrojtjes më 6 dhjetor 2021. Kjo datë do të rishikohet në konferencën përgatitore për Mbrojtjen. Trupi Gjykses parasheh që Mbrojtja t'i paraqesë provat e veta më 6-9 dhe 16-17 dhjetor 2021 dhe, nëse është e nevojshme, në janar 2022.

15. Për sa u përket pyetjeve të mëtejshme nga Mbrojtja për dëshmitarët e SPO-së, Trupi Gjykses vëren se sipas rregullës 102(3) të Rregullores pritet ende vendimi mbi një çështje shtesë. Duke pasur parasysh se nuk ka gjasa që të ketë një vendim përfundimtar për këtë çështje deri më 16 nëntor 2021, Trupi Gjykses e vlerëson të përshtatshme që të shqyrtojë çdo kërkesë të tillë nga Mbrojtja në një datë të mëvonshme, brenda afatit të parashikuar në urdhrin gojor të lartpërmendur.

¹⁰ F00312, Prokurori i Specializuar, *Kërkesa të Prokurorisë në lidhje me Dëshmitarë të Mbrojtjes*, 15 shtator 2021, konfidenciale; F00329, Mbrojtja e Gucatit, *Përgjigje ndaj Kërkesave të Prokurorisë në lidhje me Dëshmitarë të Mbrojtjes*, 27 shtator 2021, konfidenciale; F00330, Mbrojtja e Haradinajt, *Përgjigje e Mbrojtjes ndaj Kërkesave të Prokurorisë në lidhje me Dëshmitarë të Mbrojtjes*, 27 shtator 2021, konfidenciale; F00376, Mbrojtja e Haradinajt, *Parashtrim i Aktekspertizës nga Mbrojtja e z. Haradinaj me shtojcë*, 15 tetor 2021; F00386, Mbrojtja e Haradinajt, *Parashtrimi i Udhëzimeve të Mbrojtjes për Dëshmitarin Ekspert 17 me Shtojcën Konfidenciale 1*, 20 tetor 2021; F00388, Prokurori i Specializuar, *Kundërshtim i Prokurorisë në lidhje me Ekspertin e Propozuar të Mbrojtjes dhe Aktekspertizën e tij*, 22 tetor 2021; F00394, Mbrojtja e Haradinajt, *Kërkesë e Mbrojtjes për Shtimin e Një Eksperti në Listën e Saj të Dëshmitarëve të Mundshëm*, 23 tetor 2021, konfidenciale; F00410, Mbrojtja e Haradinajt, *Përgjigja e Mbrojtjes ndaj Kundërshtimit të Prokurorisë në lidhje me Ekspertin e Propozuar të Mbrojtjes dhe Aktekspertizën e tij*, 1 nëntor 2021, konfidenciale; *Shih gjithashtu F00410RED; F00426, Mbrojtja e Haradinajt, Parashtrim i Aktekspertizës nga Mbrojtja e z. Haradinaj me dy shtojca*, 9 nëntor 2021.

IV. VENDIM

16. Duke pasur parasysh çka më sipër, dhe për të lehtësuar zhvillimin e drejtë dhe të shpejtë të procesit gjyqësor, Trupi Gjykes:

- a. **UDHËZON** ZPS-në të dorëzojë një njoftim me shkrim për mbylljen zyrtarisht të paraqitjes së provave të veta në pajtim me rregullën 129 të Rregullores, deri më **10 nëntor 2021 në orën 16:00**;
- b. **URDHËRON** Mbrojtjen të dorëzojë mocionin e vet përkatës në pajtim me rregullën 130(2) të Rregullores deri më **17 nëntor 2021 në orën 16:00**; dhe
- c. **URDHËRON** ZPS-në të dorëzojë kundërpërgjigjen e vet në pajtim me rregullën 130(2) të Rregullores deri më **24 nëntor 2021 në orën 16:00**.

17. Në rast se Trupi Gjykes nuk i hedh poshtë të gjitha akuzat në pajtim me rregullën 130 të Rregullores, Trupi Gjykes:

- a. **URDHËRON** Mbrojtjen të paraqesë, deri më **29 nëntor 2021**, parashtrimet e veta në pajtim me rregullën 119(2) të Rregullores;
- b. **CAKTON** që konferenca përgatitore për Mbrojtjen të mbahet më **2-3 dhjetor 2021**; dhe
- c. **CAKTON PARAPRAKISHT** datën për hapjen e paraqitjes së provave prej Mbrojtjes më **6 dhjetor 2021**.

_____/nënshkrim/_____

Gjykatës Çarls L. Smith, III
Kryegjykatës

E martë, 9 nëntor 2021
Hagë, Holandë